

Zu Mes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

URDHËR

Nr. 59, datë 28/06 /2019

MBI

“MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E UDHËZIMIT TË PËRBASHKËT NR. 1, DATË 07.06.2019 “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”, NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; **Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 295, datë 10.05.2019, Për “përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2019-2020”;** **Urdhri i përbashkët Nr. 1, datë 07.06.2019, “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2019-2020”;** **Udhëzimit Nr. 10, datë 15.05.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”;** Vendimeve të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve si më poshtë: VSA Nr. 7, datë 23.01.2019; VSA Nr. 8, datë 23.01.2019; VSA Nr. 9, datë 23.01.2019; VSA Nr. 15, datë 09.04.2019; VSA Nr. 16, datë 09.04.2019; VSA Nr. 17, datë 09.04.2019; VSA Nr. 21, datë 29.05.2019; VSA Nr. 22, datë 29.05.2019,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2019 - 2020, me përbërje si më poshtë:
 - Arian Paço
 - Erald Bakalli
 - Ted Kamberi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Dekanët e Fakulteteve të UART, brenda datës 10 gusht, të marrin masat për shkarkimin nga Portali U-Albania të listës së aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit, afishimin e tyre në mjediset e fakulteteve si dhe të dërgohen për tu publikuar në faqen zyrtare elektronike të UART në adresat e E-mail it@uart.edu.al.
3. Regjistrimi i konkurrentëve për në konkurset e pranimit në programet e studimit me kohë të plotë Bachelor, në të gjitha Fakultet e UART, për të gjitha programet e studimeve të ofruara bëhet pranë sekretarive mësimore, dhe fillon në datën **13 Gusht 2019 nga ora 08:00 deri më orën 16:00**. Konkurrentët të regjistrohen deri në orarin e përcaktuar nga secili fakultet për fillimin e konkurseve të pranimit.
4. Konkurset e pranimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e UART do të zhvillohen nga data **20 Gusht 2019 deri më datën 23 Gusht 2019**.
5. Dokumentacioni për tu regjistruar në konkurset e pranimit bëhet me dokumentet si më poshtë:
 - PAGESA E TARIFËS SË KONKURRIMIT;
 - Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.
6. Regjistrimi pranë sekretarive përkatëse bëhet nga vetë konkurenti ose nga një person i autorizuar prej tij/saj, me prokurë të posaçme.
7. Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurset e pranimit të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
8. I gjithë kalendari i procedurave do të bëhet në zbatim të **Urdhrit të përbashkët Nr. 1, datë 07.06.2019**, "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2019-2020*".
9. Të afishohen në mjediset e secilit nga Fakultetet e UART, Urdhrat/Vendimet mbi masat e marra për konkurset e pranimit, rregulloret dhe Kriteret e konkurseve të pranimit, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme mbi këtë proces.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e grupit të monitorimit, Dekanët e Fakulteteve të UART, Përgjegjësit e Njësive Bazë, Sekretaritë e Fakulteteve, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sektori Mësimor, Sektori i Teknologjisë Informacionit, Sektori i Statistikë Informacionit, Sektori i Shërbimeve.
11. Të njoftohet për marrjen e masave të veçanta për administrimin dhe ruajtjen ambienteve të UART, për periudhën e konkurseve, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike OKTAPUS.
12. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof. Kastriot ÇAUSHI

UNIVERSITETI I ARTEVE